Drive

PORSCHE
ALBANIA

12/19

LETËR 100% E RICIKLUAR
100% RECYCLED PAPER

06 ŠKODA Superb
15 Volkswagen ID.3
19 Multivan i Ri
New Multivan

Përmbajtja

Content

7 Pyetje-Përgjigjet
7 Questions-Answers 06

ŠKODA KAMIQ 12

Volkswagen ID.3 14

Ofensiva elektrike e SEAT
SEAT's electric offensive 20

Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.
Realizimi: Botues Porsche Albania,
Realizimi grafik: Sourceone

Burimi: Audi: Audi-Mediaservice.com,
SEAT: media.SEAT.com,
Volkswagen Makina Tregtare: volkswagen-media-services.com,
Volkswagen Magazine
ŠKODA: press.ŠKODA-auto.com.

Për komente, pyetje apo sugjerime ju lutem na kontaktoni në office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (04) 240 74 30.

Porsche Albania,
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Rr. Monun.
Telefon: +355 (04) 240 74 30,
Fax.: +355 (04) 240 74 34,
e-mail: office@porsche.al; http://www.porsche.al

I dashur lexues,

Dear Reader,

Erilda Hoxha - Drejtor Marketingu Porsche Albania
Marketing Manager Porsche Albania

Dëshirojmë shumë që ky vit që po lëmë pas të ketë qenë një vit i suksesshëm dhe i mbarë për ju, pasi ne si Porsche Albania duam që pozitiviteti të jetë kudo rreth nesh.

Ne mbyllim një vit plot me sfida, suksese, momente të bukura dhe synime të reja për vitin që vjen.

Në 6 muajt e kaluar patëm kënaqësinë që të prezantojmë përpara jush disa makina tërësisht të reja.

ŠKODA Scala ishte makina që u prezantua në një mbrëmje të Premte të fund Shtatorit mes miqsh, të ftuarish dhe entuziastësh të automobilizmit.

Muaji Tetor njihet ndryshe edhe si muaji i sensibilizimit për kujdesin ndaj kancerit të gjirit, kështu që vendosëm që të dhurojmë 1 euro për çdo kilometër të përshkruar në test-drive.
Në fund të muajit Nëntor planifikuam të ndihmojmë Trees for Lura në misionin e tyre për të mbjellë pemë në parkun e Lurës, por tërmeti tragjik i 26 Nëntorit ndryshoi planet dhe vendosëm që bashkë me ta t'i vinim në ndihmë si staf të dëmtuarve. Për këtë vendosëm edhe t'iu japim disa këshilla se si të ruheni në rast tërmeti në makinën tuaj, këshilla të cilat i gjeni në faqet e kësaj reviste.

Ndërkohë, fillimi i muajit dhjetor na gjeti në Korçën e bukur në një udhëtim me disa influencers nën drejtimin e të resë Volkswagen T-Cross. Qyteti i serenatave nuk e kurseu mikpritjen teksa sa vjen e i afrohemi ditëve me dëborë.

E teksa temperaturat ulen akoma edhe më shumë, më i madh duhet të jetë edhe kujdesi që duhet të tregojmë për makinën. Nëse nuk dini nga t'ia nisni, kemi renditur disa pika të cilat do t'ua bëjnë më të lehtë dhe të sigurtë drejtimin e makinës në muajt e ftohtë.

Ndërkohë aplikacioni "Makina Ime" ka qenë një copëz tepër e rëndësishme në mozaikun tone. Ai çdo ditë i vjen në ndihmë përdoruesve të tij, numri i të cilëve sa vjen e shtohet, duke u bërë platforma e vetme online në formën e një aplikacioni në tregun automotiv shqiptar.

Për më shumë, shfletoni faqet e revistës Drive!

Lexim të këndshëm.

We really wish that this year we are leaving behind was a successful and good year for you because we at Porsche Albania want positivity to be all around us.

We are closing a year full of challenges, successes, beautiful moments, and new goals for the new year.

During the past 6 months, we had the pleasure of introducing some entirely new cars to you.

ŠKODA Scala was the vehicle that was introduced at a Friday evening at the end of September, among friends, guests, and automobile enthusiasts.

October is otherwise known as the month of breast cancer awareness, so we decided to donate 1 Euro per kilometer driven during test drives.

At the end of November, we planned to help Trees for Lura in their mission to plant trees in the Lura park, but the tragic November 26 earthquake changed plans and we decided, together with them, to help those affected from the disaster. Therefore, we decided also to provide some pieces of advice on how to protect yourselves in your car in case of an earthquake, which may be found in the pages of this magazine.

Meanwhile, the start of December found us in beautiful Korça, during a trip with some influencers under the guide of the new Volkswagen T-Cross. The city of serenades did not spare its welcome as we come increasingly closer to snowy days.

As the temperatures keep dropping, the care we should show for our car should keep growing. If you don't know where to start, we listed some items that will make it easier and safer to drive your vehicle in the close months.

Meanwhile, the "Makina Ime" app was a very important piece of our mosaic. Every day, it helps its new users, whose number keeps growing, becoming the sole online platform in the form of an app in the Albanian automobile market.

For more, please go through the pages of Drive!

Happy reading!

Nën tingujt e Offchestra dhe nën shoqërinë e miqve të mirë, Skoda prezantoi në pasditen e 27 shtatorit modelin e saj më të ri të quajtur Scala.

"Viti 2019 do të jetë përsëri një vit i suksesshëm fiskal për Porsche Albania. Ky vit ishte edhe viti i risisë së madhe në Porsche Albania; ne për herë të parë kemi sjellë të ardhmen, tani. Aplikacioni makina ime tashmë do të jetë platforma jonë e komunikimit." Kështu u shpreh Z. Gentian Bushati, drejtor i përgjithshëm i POAL.

Me një karakter, teknologji dhe emër të ri, ŠKODA SCALA ridefinon tërësisht segmentin e makinave kompakte të kompanisë Çeke. Emri "SCALA" vjen nga Latinishtja që do të thotë "shkallë". Ky hatchback kombinon dizajnin emocionues me një nivel të lartë funksionalitetesh gjithashtu edhe teknologjitë më të fundit të lidhjes, dhe trasmeton gjuhën sensacionale të dizajnit të konceptit VISION RS për herë të parë në një makinë të prodhimit në masë. Një variacion prej 5 motorrësh janë të disponueshëm, me fuqi që shkojnë nga 66 kW (90PS) deri në 110 kW (150 PS). Veç kësaj, SCALA ofron një nivel të lartë të sigurisë active dhe passive, drita të parme dhe të pasme LED, tepër hapësirë për bagazhet dhe pasagjerët, gjithashtu edhe shumë opsione Simply Clever.

Ashtu siç shprehet edhe Bernhard Maier, CEO i ŠKODA, "Jemi duke filluar një kapitull të ri në gamën e makinave kompakte me SCALA. Është një model tërësisht i ri që vendos një standard të ri brenda segmentit përsa i përket teknologjisë, sigurisë dhe dizajnit. SCALA në mënyrë perfekte materializon tipiken 'smart understatement' të ŠKODA. Jemi të bindur se SCALA ka shansin më të mirë që ridefinojë segmentin A për ŠKODA."

Me prezantimin e SCALA, ŠKODA është duke bërë disa hapa përpara në zhvillim, njëkohësisht është duke e ripozicionuar veten në segmentin e makinave kompakte. Me lidhjet e saj ekselente, paisjet e cilësisë së lartë dhe materialet elegante, në mënyrë perfekte dëshmon setin e vlerave të markës, që janë të përmbledhura në mënyrë perfekte në termin 'smart understatement'. SCALA i dedikohet një grupi njerëzish në moshë të re, përdorues interneti që pëlqejnë dizajnin, por gjithashtu i kushtojnë rëndësi hapësirës të madhe tipike të ŠKODA, bagazhit më të madh në segment dhe me një çmim të leverdisshëm.

Por le të flasim pak më në detaj se ç'ka përmban me të vërtetë ŠKODA Scala.

Dizajni i jashtëm: SCALA është e para që implementon etapën e rradhës së gjuhës së dizajnit të kompanisë. Ajo është e para e cila mban shkrimin ŠKODA sipër në kapakun e bagazhit dhe jo më logon e kompanisë. Disqet e aluminit shkojnë maksimumi 18-inch dhe krijojnë aksente dinamike; dritarja unike e pasme e zgjatur e cila është pjesë e paketës Emotion i jep SCALA-s stilin e saj.

Dizajni i brendshëm: ai bazohet në konceptim VISION RS duke kombinuar ergonominë dhe emotiven me hapësirën e madhe tipike të ŠKODA. Një afmosferë e këndshme krijohet nga dritat, ndriçimi i brendshëm, ngjyrimet e ngrohta dhe qepjet me ngjyra që krijojnë kontrast, të cilat janë opsionale në mikrofibër Suede. Opsionale janë ngrohësi i xhamit të përparmë dhe i timonit.

Motorrët: Motorrët e disponueshëm janë 3 1.0 ose 1.5 litër TSI dhe një 1.6 litër TDI. Motorri 1.0 G-TEC prodhon 66kW (90PS), që është dizejnuar të punojë në mënyrë ekologjike me gaz natyral (CNG), do të dali në vazhdim. 5 motorrë efiçent me turbo përmbushin standardin e emetimeve Euro 6d-TEMP. Sport Chassis Control është i disponueshëm si opsion – një shasi që mund të ndërrohet midis Normal ose Sport me anë të Driving Mode Select.

Sistemet e asistencës: Shumë nga këto sisteme të asistencës janë ofruar vetëm në makinat e një segmenti më sipër. Side Assist tregon kur një makinë po vjen nga pas dhe do që të parakalojë ose nëse është në pikën e vdekjes së pasqyrës deri në 70m larg – 50m më larg se në Blind Spot Detect. Adaptive Cruise Control (ACC), që mund të përdoret në shpejtësi deri në 210 km/h dhe Park Assist janë opsionale. Lane Assist dhe Front Assist me City Emergy Brake të cilat bëjnë të mundur që makina të frenojë vetë për të parandaluar impaktin janë standarde.

Teknologjia dhe siguria: Makina ka 9 airbag duke përfshirë edhe gjunjët e shoferit, dhe për herë të parë në segment, airbag anësor të pasëm. Në rast përplasje, sistemi Crew Protect Assist automatikisht mbyll xhama dhe forcon rripat e sigurimit në një moment të përshtatshëm.

Infotainment: opsionali Virtual Cockpit ka një ekran 10.25 inch – më i madhi në segment. Kryesisht ato vijnë në përmasa nga 6.5 deri në 9.2 inch. Ekrani me prekje është i vendosur lart në panelin e mesit në një pozicion komod për shoferin dhe pasagjerët; opsionali ŠKODA Sound System përfshin një subwoofer dhe 10 speaker. Duke përdorur shumë nga shërbimet online të ŠKODA Connect, makina mund mbyllet dhe hapet nga smartphone, mund të bëhen update sistemi dhe hartat. SCALA është gjithmonë online falë SIM-it të integruar me lidhje LTE.

Simply clever: për herë të parë në segement – bagazh elektrik.

Skoda Albania ka filluar dorëzimet e para të modeleve Scala që pak ditë pas eventit Scala Night.

ŠKODA SCALA

Under the sounds of Offchestra and in the company of good friends, ŠKODA introduced in the afternoon of September 27 its newest model called Scala.

"2019 will be yet again another successful fiscal year for Porsche Albania. This year was also the year of the new novelty at Porsche Albania; for the first time, we have brought the future, now. The Makina Ime app will now be our communication platform." That is what Mr. Gentian Bushati, General Director of POAL, said.

With a new character, technology, and name, the ŠKODA SCALA entirely redefines the Czech company's compact vehicle segment. The name "SCALA" comes from Latin and means "stairs." This hatchback combines an exciting design with a high degree of functionality as well as the latest interconnection technologies and transmits the sensational language of the VISION RS concept design for the first time in a mass production vehicle. With a range of 5 available engines, with horsepower ranging from 66 kW (90PS) up to 110 kW (150 PS). Besides, the SCALA offers a high level of active and passive safety, front and rear LED lights, ample space for luggage and passengers, as well as many Simply Clever options.

As ŠKODA CEO Bernhard Maier says, "We are starting a new chapter in the compact range with the SCALA. It is an entirely new model that sets a new standard within the segment in terms of technology, safety, and design. The SCALA perfectly materializes the typical 'smart understatement' of the ŠKODA. We are confident the SCALA has the best chance of redenifing the A segment of the ŠKODA."

With the introduction of the SCALA, ŠKODA is making several steps forward in development and at the same time is repositioning itself in the compact vehicle segment. With its excellent interconnections, high-quality equipment and elegant materials, it perfectly testifies to the values of the brand, which are perfectly summarized under the term 'smart understatement'. The SCALA is dedicated to a group of people who are young, internet users who like design, who also appreciate greater typical space of the ŠKODA, the largest luggage compartment in the segment and a convenient price.

Let's talk in more detail about what the ŠKODA SCALA really contains.

Exterior design: The SCALA is the first to implement the next phase of the company's design language. It is the first to bear the ŠKODA writing on top of the hood and not the company logo. The aluminum discs are max 18 inch and create dynamic accents; the unique extended rear window that is part of the Emotion package gives the SCALA its style.

Interior design: It is based on the VISION RS concept, combining ergonomics and the emotive with the typical large space of the ŠKODA. A nice environment is created by the interior lighting, warm colors and colorful seams that create contrast, and which are optional in suede microfiber. The front windshield and steering wheel heaters are optional.

Engines: Available engines are 3 1.0 or 1.5 litre TSI and a 1.6 litre TDI. The 1.0 G-TEC engine puts out 66kW (90PS), which is designed to work ecologically on natural gas (CNG), to come out later. 5 efficient turbo engines fulfill the Euro 6d-TEMP emission standard. Sport Chassis Control is available as an option – a chassis that may be switched between Normal and Sport through a Driving Mode Select.

Assist systems: Many of these systems are offered only in higher segment vehicles. The Side Assist indicates when a car is coming from behind and seeks to overtake or is at a dead point from the mirror up to 70m away – 50m farther than in the Blind Spot Detect. Adaptive Cruise Control (ACC), which may be used at speeds up to 210 km/h and Park Assist are optional. Lane Assist and Front Assist with City Emergy Brake that make it possible for the vehicle to brake itself to prevent impact are standard.

Technology and safety: The vehicle has 9 airbags, including driver knees and, for the first time in the segment, a rear side airbag. In case of crash, the Crew Protect Assist automatically closes the windows and tightens security belts at a proper moment.

Infotainment: The Virtual Cockpit option has a 10.25 inch display screen – the largest in the segment. They usually come in 6.5 to 9.2 inches. The touch screen is placed high in the middle dashboard at a comfortable position for the driver and passengers; the optional ŠKODA Sound System includes a subwoofer and 10 speakers. Using many of the ŠKODA Connect online services, the vehicle closes and opens from a smartphone and the system and maps can be updated. The SCALA is always online thanks to the LTE connected integrated eSIM.

Simply clever: for the first time in the segment – electric bonnet.

ŠKODA Albania began the delivery of the first SCALA models after the SCALA Night event.

Drive for a Cause

“Të ngasësh makinën për një kauzë”. Porsche Albania jep mundësinë të kontribuojmë në luftën kundër kancerit të gjirit.

Të jesh i aftë dhe në gjendje për të kryer të gjitha aktivitetet e përditshme është një bekim i madh. Kjo gjë vjen falë një shëndeti të mirë dhe të mirëkontrolluar. Por, dita ditës dëgjojmë raste të dhimbshme të sëmundjeve të ndryshme që vijnë dhe si pasojë e mosdiagnostikimit në kohë.

Një ndër këto sëmundje është dhe kanceri i gjirit. Muaji tetor është pikërisht maji i ndërgjegjësimit ndaj këtij lloji kanceri që fatkeqësisht bën që në Shqipëri të preken 350-400 femra çdo vit, ndërsa sipas OBSH 1 në 9 në gra/vajza sëmuret nga ky lloj kanceri.

Kontrolli i shpeshtë tek mjeku dhe kapja në kohë e sëmundjes janë dy faktorët që ndikojnë në uljen ndjeshëm të numrit të grave që fatkeqësisht ndërrojnë jetë.

Kjo kauzë sociale ka një rëndësi të veçantë për Porsche Albania dhe ne jemi tepër të ndjeshëm ndaj kauzave të tilla ndaj vendosëm që për muajin tetor të bashkëpunojmë me qendrën Europa Donna Albania.

Dhuruam 1 Euro për çdo kilometër TEST DRIVE të përshkruar nga vetë njerëzit, për qendrën Europa Donna Albania.

Kjo organizatë ka në fokus përmirësimin e cilësisë së jetës së grave me kancer gjiri duke i plotësuar kushtet dhe nevojat që ato kanë, duke iu siguruar ndihmë e duke frymëzuar shpresë.

Si u bë e mundur kjo?

Personat që u bënë pjesë e kësaj iniciative të përbashkët, ku ajo që ndodhi ishte thjesht një TEST DRIVE pra një xhiro me një nga makinat e brandeve tona (Audi, Volkswagen, Skoda & Seat), u shoqëruan nga konsulentët e shitjeve në mënyrë që kilometrat e përshkuar të shkonin për një kauzë të mirë.

Ky TEST DRIVE u realizua nga personat që janë të interesuar për të blerë një makinë të re, si dhe nga fansat e industrisë automotive. Fakti që me anë të kësaj do të mund të kontribuonin edhe në kauzën e rëndësishme të ndërgjegjësimit ndaj kancerit të gjirit, e bëri eksperiencën dyfish të vlefshme.

#driveforacause

“Drive for a cause.” Porsche Albania gives the opportunity to contribute in the fight against breast cancer

Being able and capable to carry out all daily activities is a great blessing. That comes thanks to good and well-checked health. Yet, day after day, we hear of painful cases of different diseases that come also as a consequence of lack of timely diagnosis.

One of these diseases is breast cancer. October is the breast cancer awareness month, which unfortunately in Albania affects 350 to 400 women every year, and according to the WHO, 1 of every 9 women/girls is diagnosed with this kind of cancer.

Frequent checkups at the doctor and timely diagnosing of the disease are the two factors that influence the considerable reduction of the number of women who unfortunately pass away.

This social cause is of special significance to Porsche Albania and we are very sensitive to such causes. That is why we decided to collaborate with the center Europa Donna Albania for the month of October.

We donated 1 Euro per each kilometer of TEST DRIVE done by people, for Europa Donna Albania.

This organization’s focus is on improving the quality of life of women with breast cancer, meeting their conditions and needs and providing assistance and inspiring hope.

How did it all work?

Persons who became part of this joint initiative did a TEST DRIVE, a ride with one of the cars of our brands (Audi, Volkswagen, Skoda & Seat), accompanied by sales consultants, so that the kilometers driven would be for a good cause.

This TEST DRIVE was done by people interested in purchasing a new vehicle and fans of the automobile industry. The fact that through this initiative, we would also contribute to the important cause of breast cancer awareness made the experience twice as useful.

#driveforacause

Porsche Albania, shëmbulli që duhet ndjekur.

Tirana Auto Sallon e cila u zhvillua në datat 10 deri 13 tetor kishte si pjesëmarrës edhe kompaninë më të madhe të shitjes së makinave, Porsche Albania.

Në këtë edicion të katërt të Tirana Auto Sallon ishin edhe shumë kompani të tjera të markave të ndryshme që operojnë në tregun automotiv shqiptar me të gjithë arsenalin e tyre të modeleve më të reja. Ndryshe nga të tjerët, stenda e Porsche Albania solli tepër inovacion, por nuk kishte asnjë makinë.

Përfaqësimi në këtë panair, i dedikohej tërësisht teknologjisë dhe dixhitalizimit.

Aplikacioni "Makina Ime" është ajo ç'ka ka bërë ndryshimin në tregun automotiv shqiptar, ashtu si edhe në këtë panair" – deklaroi Drejtoresha e Marketingut dhe PR, Znj. Erilda Hoxha.
Deri më tani, ky aplikacion u ka ardhur në ndihmë përdoruesve me nevoja të ndryshme, si: pagesën e parkimit, aplikimin për pjesë këmbimi, llogaritjen e doganës, llogaritjen e kësteve me Porsche Leasing, aksesin me flotën e makinave tona të përdorura informacionet më të reja të industrisë, kontrollin mbi gjobat, testin e patentës etj.

Qëllimi i "Makina Ime" është shumë i thjeshtë, vazhdon Znj, Hoxha, "t'i lehtësojë jetën përdoruesve për transport pa asnjë kosto dhe të dixhitalizojë mënyrën e komunikimit duke sjellë të ardhmen tani". Të gjithë jemi dëshmitarë që të paktën 5 vitet e fundit teknologjia është zhvilluar me ritme tepër të shpejta. Makinat elektrike, drejtimi autonom i makinës, inteligjenca artificiale etj., janë bërë tashmë diçka e zakonshme për të gjithë. Gjithashtu, edhe përdorimi i smartphone nga të gjitha moshat është rritur. Tashmë, jo vetëm të rinjtë janë të lidhur me internetin.

Thuajse gjithçka sot është e disponueshme pas ekraneve, duke na kursyer kohë dhe energji për të kryer detyra të caktuara. Kështu që Porsche Albania, si kompania më prestigjoze në tregun automotiv vendas, nuk mund të rrinte duarkryq. Prej disa vitesh sollëm këtë aplikacion dhe tashmë, prej fillimit të këtij viti, aplikacioni "Makina Ime 2" është i disponueshëm për të gjithë përdoruesit e platformave Android dhe iOS. Për t'iu përgjigjur kërkesave të klientëve dhe nevojave për të zhvilluar më tej biznesin, u investua në 2019 për një version më të avancuar teknikisht, vizualisht, si edhe në përdorim. Vetëm disa muaj më pas, "Makina Ime" vjen më e kompletuar, duke u bërë një "hub" për të gjithë dashamirësit e automobilizmit dhe personave të cilët janë të interesuar për të blerë një makinë të re ose të përdorur.

Tashmë nuk është e rëndësishme vetëm të ofrosh një produkt të duhur për konsumatorët, apo shërbimin e mirë ndaj klientit, por edhe të ecësh me hapin e kohës dhe të jesh lider në inovacion dhe teknologji duke mos ngelur te tradicionalja, por duke bërë diferencën me anë të mendësive ndryshe nga e zakonshmja. Versioni i ri i "Makina Ime" do të jetë i disponueshëm për të gjithë përdoruesit në platformat Android dhe iOS.

Këtë eksperiencë e prespektivën e Porsche Albania si dhe zhvillimin e tregut nëpërmjet politikave shtetërore në këtë fushë, patëm mundësi ta diskutojmë edhe në forumin e organizuar në këtë panair me perfaqësues të Qeverisë, Ministrin e Mjedisit Z. Blendi Klosi, eksponentë të DPTRRSH si dhe të Policisë së Shtetit.

Panairi
The Fair

Porsche Albania, the example to follow.

One of the participants in the Tirana Auto Salon, which took place between October 10 and 13, was the greatest car sales company, Porsche Albania.

In this fourth edition of the Tirana Auto Salon, there were also many other companies of different brands operating in the Albanian automobile market with all their arsenal of new models. Unlike the others, the Porsche Albania stand brought a lot of innovation, but included no cars.

"Representation in this fair was dedicated exclusively to technology and digitalization. The "Makina Ime" app is what has made the difference in the Albanian automotive market, as well as in this fair," – said Marketing and PR Director Ms. Erilda Hoxha. So far, this application has been helpful to users for their different needs, such as: paying for parking, application for car parts, calculation of customs fees, calculation of installments for Porsche Leasing, access to the fleet of our used vehicles, the latest industry information, checks on fines, the driving license test, etc.
The purpose of "Makina Ime" is very simple, Ms. Hoxha continues, "make users' lives easier in terms of transport without costs and digitalize the manner of communication by bringing the future now." We are all witnesses to the fact that at least in the last five years, technology has developed at a very fast pace. Electric cars, autonomous driving, artificial intelligence, etc., have become something customary for all. Also, the use of smartphones by all ages has grown. Now, it is not just the young who are connected to the internet.

Almost everything today is available behind screens, saving us time and energy to carry out certain tasks. Thus, as the most prestigious company in the local automotive market, Porsche Albania could not sit back. We brought this app a few years ago and now, since the start of this year, the "Makina Ime 2" app is available for all users on the Android and iOS platforms. To respond to the demands of customers and the needs to further develop our business, we invested in 2019 in a version that is more advanced technically, visually, and in terms of use. Only a few months after, "Makina Ime" comes more complete and becomes a "hub" for automobile lovers and persons interested in buying a new or used vehicle.

Now it is not important to only offer the right product or a good service for consumers, but also to walk at the pace of time and be a leader in innovation and technology, not being stuck on the traditional, but making the difference through a mentality that is different from the ordinary. The new version of "Makina Ime" will be available to all users on the Android and iOS platforms.

We had the opportunity to discuss this experience and the perspective of Porsche Albania regarding market development through state policies in this area at the forum organized in this far with representatives of the Government, Minister of Environment Mr. Blendi Klosi, officials of the AGDRT and State Police.

Seat Terraco

Tarraco – quajtur kështu sipas emrit të vjetër për sportin spanjoll të Tarragonas – plotëson treshen e SUV-ve të SEAT, duke iu bashkuar ARONA-s së vogël dhe ATECA's së mesme.

SEAT Tarraco është një makinë e shkëlqyer familjare, me plot hapësirë për pesë të rritur dhe dy sedilje opsionale në bagazh që janë shumë të dobishme për fëmijë. Është e lehtë në drejtim dhe ka një gamë motorësh që janë të lirë në funksionim.

SEAT Tarraco është po aq e bollshme për sende sa është edhe për njerëz. Ka disa hapësira të vogla nëpër kabinë dhe mund të specifikosh veçoritë e dobishme si karikimi i telefonit pa kabllo.

Edhe bagazhi është menduar mirë. Ka hapësirë për një valixhe të vogël edhe nëse të gjitha sediljet përdoren por, kur janë vënë në punë vetëm pesë sedilje, hapësira është masive – dhe mund të gllabërojë lehtësisht disa valixhe pa u menduar dy herë. Edhe detyrat e mëdha janë të thjeshta për sepse të gjitha sediljet e pasme palosen plotësisht në dysheme dhe bagazhi gjigand e bën maksimalisht të lehtë edhe ngarkimin e sendeve më të mëdha.

Çdo SEAT Tarraco ka plot hapësirë në mes ndaj nuk ka rëndësi nëse ti dhe pasagjeri i parë jeni të gjatë, sepse personat pas prapë do të kenë plot hapësirë për gjunjët. Sedilja e mesit nuk është aq e rehatshme sa ato dy anash, por ka plot hapësirë dhe mund të ulen tre persona të rritur.

SEAT Tarraco është në dispozicion me një zgjedhje katër motorësh, ndarë barabar midis benzinës dhe naftës.

Motori 150kf 1.5 litra me benzene është ai bazë në gamën SEAT Tarraco dhe – në varësi të llojit të drejtimit që bën – është edhe një nga opsionet më të mira. Është i qetë, i lehtë dhe i shpejtë pasi je nisur, ndihmuar nga një kambio me gjashtë marshe moderne në përdorim. Arrin 0-100 km/orë në 9.7 sekonda dhe harxhon 6.2 l/100 km.

Nëse dëshiron të kombinosh fuqinë e benzinës me kambion automatike dhe të katër rrotat aktive, duhet të zgjedhësh modelin 190hp 2.0-litra model. Nuk ndihet sikur është kushedi më i shpejtë se ai bazë, por as nuk kushton shumë më tepër për të punuar.

Nëse kryen shumë udhëtime të gjata ose shpesh e ke makinën të ngarkuar plotësisht, një prej motorëve të fuqishëm të naftës do ishte opsion më i mirë. Modeli 150hp 2.0-litra është model i shkëlqyer në çdo drejtim që harxhon 4.7 l/100km dhe arrin nga 0 në 100 km/orë në 9.8 sekonda. Në autostradë, ndihet më i fuqishëm se modelet e benzinës, plus që mund të zgjedhësh atë me katër rrotat aktive dhe kambion automatike me shtatë marshe që punon vaj.

Modeli i naftës 2.0-litra 190hp ka motorin bazë dhe atë me katër rrota aktive si standard, por dallimi në performancë është aq i vockël (shkon 0-100 km/orë në 8.0 sekonda) sa që më mirë të kursesh paratë. Nëse nuk do të kesh patjetër motorin më të fuqishëm.

Me gjithë amortizatorët modernë, Seat Tarraco ndihet më e rehatshme në autostratë. Në shpejtësi të larta, i përcjell mirë të ngriturat dhe kabina mbetet mjaft e qetë. Modelet Xcellence e sipër kanë si standard edhe kontrollin e drejtimit (cruise control), i cili ia lë makinës detyrën e frenimit dhe rritjes së shpejtësisë.

Modelet Xcellence po ashtu vijnë edhe me një kamera të pasme, duke e bërë më të lehtë që të futësh Tarraco-n e madh në hapësira të vogla parkimi.

Megjithatë, edhe pa këtë paketë moderne, Tarraco nuk është i vështirë të drejtohet në qytet falë kontrollit të dritave dhe sensorëve standardë të pasmë të parkimit. Po ashtu, ia vlen të dini që të gjitha modelet vijnë me frenim automatik emergjence që aktivizohen fort nëse makina pikas një përplasje së afërmi.

The Tarraco – named after the old name for the Spanish port of Tarragona – completes Seat's threesome of SUVs, joining the little Arona and midsize Ateca.

The SEAT Tarraco is a great family car with loads of space for five adults and a pair of occasional seats in the boot that are great for kids. It's easy to drive and has a range of engines that are cheap to run.

The SEAT Tarraco is just as spacious for stuff as it is for people. You get loads of smaller storage bins scattered around the cabin and you can specify handy features like wireless phone charging.

Even the boot is well thought out. It has space for a small suitcase even with all the SEAT's seats in use but, with only five seats in place, it's massive – easily swallowing a set of suitcases without a second thought. Even big jobs are simple because all the back seats fold completely flat into the floor and the huge boot opening makes loading bulky items as hassle-free as possible.

Every SEAT Tarraco has loads of room in the middle row so it doesn't matter if you and your front passenger are tall because the people in the back will still have plenty of knee room. The harder centre seat isn't quite as comfortable as the outer two, but there's plenty of foot room and you can carry three adults.

The SEAT Tarraco is available with a choice of four engines split equally between petrol and diesel.

The 150hp 1.5-litre with 150 hp petrol is the entry-level point to the SEAT Tarraco range and – depending on what kind of driving you do – is also one of the best options. It's quiet, smooth and quick enough once you're under way, aided by a slick-to-use six-speed manual gearbox. It gets from 0-100 km/h in 9.7 seconds and returns fuel economy of 6.2 l/100km.

If you want to combine petrol power with an automatic gearbox and four-wheel drive then you'll need to go for the 190hp 2.0-litre model. It doesn't feel a great deal quicker than the basic petrol but equally shouldn't cost a great deal more to run.

If you'll do lots of long journeys or will often have the car fully loaded, one of the punchy diesels will be a better option. The 150hp 2.0-litre model is a brilliant all-rounder that returns fuel economy of 4.7 l/100km and gets from 0-100 km/h in 9.8 seconds. On the motorway, it feels punchier than the petrol models, plus you can have it with four-wheel-drive and SEAT's smooth shifting seven-speed automatic gearbox.
The 2.0-litre 190hp diesel gets the auto and four-wheel drive as standard, but the performance difference feels so marginal (it gets from 0-100 km/h in 8.0 seconds) you're better off saving your money unless you must have the range-topping engine.

Seat Tarraco even with the fancy dampers, feels most comfortable on the motorway. At these higher speeds it smooths out bumps well and the cabin is pretty quiet. Xcellence models and above come with active cruise control as standard which effectively hands the job of braking and accelerating over to the car.

Xcellence models also come with a reversing camera as standard, making it that bit easier to get the big Tarraco tucked away into tight town parking spaces.

Even without all this fancy kit, though, the Tarraco isn't hard to drive in the city thanks to its light controls and standard rear parking sensors. It's also good to know that all models come with automatic emergency brakes that'll slam on if the car detects an imminent collision.

0823 TCO

Trees for Lurë

Parku i Lurës është një nga parqet më të bukur dhe njëkohësisht më të dëmtuar të vendit tonë. Ai shtrihet në një sipërfaqe prej 1300ha përreth malit Kurona e Lurës (2121m mbi nivelin e detit).
Pylli përbëhet nga drurë halorë dhe gjethorë ku përhapjen më të gjerë e ka ahu që formon pyjet deri në lartësinë 1600-1700m mbi nivelin e detit. Më tej vinë edhe robulli, pisha e zezë, pisha e bardhë etj.
Një e veçantë e kësaj zone janë edhe 12 liqenet të cilët janë quajtur edhe "Liqenet e Lurës", që mbajnë emra si Liqen i Madh, Liqeni i Zi, Liqeni i Lopëve, Liqeni i Luleve etj. Ato shtrihen në shpatin lindor, në kufirin midis Lurës dhe Nezhdës. Në të jetojnë edhe shumë kafshë si ariu i murmë, riqebulli, zardafi, kaprolli, gjithashtu edhe gjeli i egër.

Ky park është një nga parqet më të veçantë në vendin tonë, por për fat të keq, parku ka pësuar shpyllëzim masiv nga prerja e paligjshme e pemëve, si dhe për shkak të një serie zjarresh.
Trees for Lurë është një projekti i nisur nga Dorjan Bulku dhe çeku Pavel Kunc, dhe ka për qëllim mbjelljen e 20,000 pemëve brenda vitit 2020. Kështu ata bashkëpunojnë me autoritetet vendase si dhe me partnerë të tjerë për të realizuar qëllimin e tyre.
Ne, si Volkswagen, ndjejmë përgjegjësi ndaj komunitetit dhe kauzave të tilla kështu që vendosëm t'i mbështesim ata me 3 makina Volkswagen Amarok.
Zgjodhëm këtë model pasi është makina perfekte për të kryer detyra të tilla. Ajo ka lartësinë e duhur nga toka, mund të mbajë pa problem 5 persona në bord dhe një motorr mjaft të fuqishëm për t'u përballur me terrene të vështira. Ajo çka e bën akoma më të veçantë, është pjesa e pasme e cila mund të qëndrojë e hapur dhe në të vendosen materiale të mëdha ose të vogla për t'u transportuar. Madje egziston edhe një opsion që pjesa e pasme mund të mbulohet dhe e gjitha të kthehet në një bagazh gjigand.

Etapa e parë u planifikua të ishte në datat 28 nëntor me 1 dhjetor 2019. Në këtë etapë do të mbilleshin rreth 2,000 pemë. Por jo vetëm kaq. Për t'i ardhur në ndihmë komunitetit të Lurës, Trees for Lurë mendoi të dhuronte edhe rroba e mjete shkollore për fëmijët. Gjithashtu, mendoi të nisë edhe një bashkëpunim me manaxherët e Parkut Kombëtar të Lurës si dhe me autoritetet vendase. E gjitha kjo, me qëllimin final, që në më pak se 1 vit, të mbjellë 20,000 pemë duke i hapur rrugën më tej rigjenerimit të parkut.

Kjo kërkon burime financiare të cilat janë duke u siguruar nga partnerët e tjerë të programit por edhe nga individë të zakonshëm të cilët duan të kontribojnë duke ndihmuar skuadrën e Trees for Lurë t'i dali me sukses qëllimit fisnik në ringjalljen e zonës e cila vitet e fundit ka rënë pre e një shpyllëzimi masiv i cili do të marri kohën e vet për t'u rikthyer edhe një herë në gjendjen e mëparshme.

Për fat të keq, kjo iniciativë nuk mundi të finalizohej për shkak të tërmetit tragjik të 26 nëntorit, shumë pak ditë përpara datës së planifikuar.

Megjithatë, projekti në një formë apo një tjetër vetëm u ndryshua dhe nuk u anullua plotësisht.

Skuadra e Trees for Lurë vendosi të asistojë në operacionet e ndihmave në zonat e prekura dhe me më shumë dëmtime nga tërmeti.

Stafi i Porsche Albania dha njëkohësisht kontributin e saj duke dërguar në zonat e prekura me anë të Trees for Lurë disa donacione ku përfshiheshin jastëk, jorgan, ilaçe dhe disa ushqime.

Dhe jo vetëm kaq, por kompania do t'i bashkohet qeverisë në punën për rindërtimin të zonave ku tërmeti u tregua më pak i mëshirshëm.

Nga ana e saj, Trees for Lurë në datën 30 Nëntor mbolli 51 pemë në lure nën emrat e 51 viktimave të tragjedisë që tronditi Shqipërinë. Por ky projekt dhe bashkëpunim nuk mbaron këtu.

Aktiviteti i Trees for Lurë do të vijojë në pranverë ku dhe do të vazhdojë mbjellja e pemëve, drejt synimit për të mbjellë 20,000 pemë brenda 1 viti.

Ndërkohë Porsche Albania do vazhdojë të jetë mbështetëse e kësaj nisme duke ofruara automjete për të lehtësuar punën, dhe rrjedhimisht duke dhënë ndihmën e saj në realizimin e qëllimit final.

The Lura Park is one of the most beautiful and, at the same time, most damaged parks of the country. It stretches over a space of 1300ha around the Lura Crown Mountain (2121m above sea level).
The forest is made up of coniferous and leaf woods, with the most spread being beech trees, forming forests at a height of up to 1600-1700m above sea level. Then there are the firs, black pine, white pine, etc. A peculiarity of this area are the 12 lakes that have been named the "Lakes of Lura," that bear names such as Great Lake, Black Lake, Cow Lake, Flower Lake, etc. They extend over the eastern slope, in the border between Lura and Nezhda. Many animals live in the area, such as the grey bear, lynx, beaver, roe, as well as the wild turkey.

The park is one of the most special in the country, but unfortunately the it has suffered massive deforestation as a result of illegal cutting of trees and due to a series of fires. Trees for Lurë is a project initiated by Dorjan Bulku and the Czech Pavel Kunc and it seeks to plant 20,000 trees within 2020. They collaborate with local authorities and other partners to achieve their goal.
As Volkswagen, we feel a responsibility to community and such causes and therefore we decided to support them with three Volkswagen Amarok vehicles.
We chose this model because it is the perfect vehicle for such tasks. It has the proper height from the ground, may easily carry 5 persons and a powerful engine to take on difficult terrains. What makes it even more special is the back, which may remain open for placing large or small items to transport. There is even an option for the back to be covered and turn into a giant luggage compartment.

The first phase was planned for November 28 – December 1, 2019, with the plan being to plant about 2000 trees. That is not all. To help the Lura community, Trees for Lurë thought of donating clothes and school items for children. They also began cooperation with the National Lura Park managers and local authorities. The ideal would be for closer cooperation to make all go according to plan and after less than one year, 20,000 be planted, thus opening the way to regenerating the park.

All this requires financial resources, which are being secured by other partners of the program but also by ordinary individuals who want to contribute by helping the Trees for Lurë team in their noble goal of regenerating an area that in recent years has been a victim of massive deforestation that will take its time to be reversed to the earlier state.

Unfortunately, the initiative was not possible to finalize due to the tragic November 26 earthquake, just a few days before the planned date.
However, in one way or another, the project was amended and not annulled.

The Trees for Lurë team decided to assist in relief operations in areas most affected by the earthquake.

The staff of Porsche Albania, at the same time, made its own contribution and sent to the affected areas, through Trees for Lurë, some donations that included pillows, quilts, medicaments, and food items.
The company will also join the government in the work to rebuild the areas where the earthquake was least merciful.

On November 30, Trees for Lurë planted 51 trees in Lurë, on behalf of 51 victims of the tragedy that struck Albania.

This project and collaboration does not end here however.

The Trees for Lurë activity will continue in the spring, when the planting of trees is to continue toward the goal of 20,000 trees in 1 year.

Meanwhile, Porsche Albania will continue to be a supporter of this initiative, offering vehicles to facilitate work, and therefore offering its own assistance toward meeting the end goal.

T-Cross

Volkswagen T Cross është një nga krijesat e reja të kompanisë nga Wolfsburg i Gjermanisë, që i shtohet games së modeleve të shumllojshme që kompania ofron.

T Cross është një makinë rinore dhe easy going. Një makinë e cila i përshtatet një stili jete dinamik dhe gjithmonë në lëvizje.

Karakteristika të tilla kërkojnë një makinë e cila diferencon nga të tjerat, në aparencë, ekonomi dhe prakticitet. Të gjitha këto, mishërohen tek T Cross.

Së fundmi modeli T Cross i është bashkuar flotës së Porsche Albania dhe është i disponueshëm për të gjithë ata që janë të interesuar për të.

Por një model i tillë duhej patjetër të merrte vëmendjen që duhet.

Për këtë, ne menduam të bënim një udhëtim drejt qytetit të Korçës nën emrin "T Cross Drive Experience". Pjesë, ishin personazhe të njohur të medias si dhe influencer të cilët i ndjekin mijëra njerëz, për të cilët ata dokumentuan të gjithë udhëtimin nga Tirana për në Korçë dhe në kthim. Të ftuarit paten mundësinë të shijojnë udhëtimin me T Cross, ushqimin dhe mikpritjen e zonës si dhe u njohën më në detaj me makinën ku kishin kaluar një pjesë të madhe të ditës së tyre. Momente të bukura, networking, dhe miq të mirë, këtë ishin termat të cilat mund të veçojmë nga ajo që ndodhi në T Cross Drive Expereince.

Por le të fokusohemi pak tek Volkswagen T Cross më në veçanti.

Cara Delevingne u zgjodh nga kompania gjermane për të qënë "#MoreThan1Thing". Sipas Jürgen Stackmann, Anëtar i Bordit të Menaxhimit të Volkswagen për Shitjet, Marketingun dhe Pas-Shitjen, imazhi i 26 është perfekt pasi të dy, si T Cross dhe Delevingne janë të rinj, cool, të shkathët dhe aktiv. Ajo është mishërimi i asaj çka ne kemi deklaruar për T Cross: "More than 1 thing".
Cara Delevingne është një modele e njohur që prej mëse 10 vitesh tashmë dhe ajo gjithashtu ka korrur sukses edhe si këngëtare, aktiviste dhe businesswoman. Tipi dhe jeta e saj lidhet fort me T Cross teksa ajo bën një jetë kreative dhe gjithmonë në lëvizje. Ajo shprehet se "mendoj se T Cross më reflekton mua dhe personalitetin tim në një mënyrë që e këndshme, e re, e ndryshueshme, dhe mund ti përshtatet menjëherë situatës që ndryshon nga momenti në moment. Është e shpejtë dhe e zhdërvjellët…dua të them…është çdo gjë!".

Për promovimin e SUV të ri fushata 360° e promovimit përfshiu spote publicitare, reklama të printuara dhe billboard, gjithashtu edhe materiale online dhe në media sociale. #MoreThan1Thing përshkruan më së miri atë çka kjo makinë përfaqëson.

T Cross mund të marri shumë emërtime, emra apo mbiemra, por vetëm një është ajo çka makina e tregon në çdo moment, dhe ai është prakticiteti. Nën sloganin "I am more" ajo vendos pikat mbi "I" dhe reflekton akoma edhe më mirë filozofinë e saj: të ofrojë më shumë se të tjerët, por duke mos kushtuar më shumë se të tjerët.
I gjithë ky slogan, ndahet në 4 pika të forta:
"I am practical" – më shumë hapësirë dhe ndryshueshmëri.
"I am cool" – dizajn i definuar dhe individual
"I am intuitive" – dixhital dhe i lidhur
"I am safe" – një nga makinat më të sigurta të kategorisë së vet.

Kjo e fundit është edhe e dokumentuar nga pale të treat si Euro NCAP (European New Car Assessment Programme) që bën teste të ndryshme për të nxjerrë rezultatet përsa i përket sigurisë 360 gradë të makinës. Volkswagen T Cross ka marrë 5 nga 5 yje në test e bëra. Madje testues indipendent të tjerë e kanë kurorëzuar atë si makinën më të sigurtë të segmentit të vet. Kjo do të thotë, ajo ka arritur standartet më të larta të sigurisë. Ajo është e paisur me shumë opsione sigurie standarte për të të cilat më parë gjendeshin vetëm tek makinat e kategorive më të larta. Të gjitha këto, bashkuar edhe me platformën fantastike kundrejt aksidenteve, e bëjnë atë unike në kategorinë e saj.

Le të futemi pak më në brendësi të T Cross.

Ajo vjen me ngjyra të cilat nuk janë tepër të zakonshme për makinat që shohim çdo ditë, si psh Energetic Orange, Reef blue, Flash red, Makena Turquoise apo Champagne Silver.
Në brendësi, ngjyra e jashtme e makinës është gjithashtu e vendosur mbi panelet e kroskotit, me dizenjo të ndryshme duke e bërë interiorin e makinës akoma e më tërheqës. Kilometrazhi dixhital është opsional teksa në panelin e mesit gjithmonë gjendet një ekran me touch i cili e bën më të lehtë kontrollin e muzikës, navigatorit, teksa Android Auto dhe Apple CarPlay janë opsionale.
Në total, pjesa e përparme e interiorit të kësaj makine është një vend i këndshëm për të qëndruar pasi ngjyrat, sistemi i multimedias si dhe dizajni i përgjithshëm, për shoferin por edhe për pasagjerin bëjnë që shpesh të duash të qëndrosh në të edhe pasi udhëtimi yt ka mbaruar dhe është kohë dalësh nga makina tashmë.

Por pjesë e kësaj pakete të kompletuar është pjesa e pasme. Pasagjerët në sediljet e pasme kanë mundësinë të ulen pa kërkuar që sediljet përpara të lëvizin pasi sediljet e pasme jo vetëm që janë të rehatshme dhe të bollshme, por gjithashtu mund të lëvizin para ose pas për t'iu përshtatur nevojës së moment. Gjithashtu 2 porta USB (4 në total) nuk do i lënë kurrë bateritë e celularëve në minimum.

Bagazhi është i bollshëm dhe mund të nivelohet sipas kërkesës. Kjo do të thotë që shtresa e poshtme e bagazhit mund të vendoset në pozicion fundor për të krijuar pak më tepër hapësirë por mundet edhe në ngrihet më sipër duke krijuar një sipërfaqe krejtësisht të sheshtë.

Në fakt, duke u fonkusuar së tepërmi tek aparenca dhe prakticiteti i T Cross, harruam më të rëndësishmet……..motorrin dhe kambiot.

